

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 94, datë 28.05.2026

**PËR
MIRATIMIN E RIEMËRIMIT TË ANËTARIT TË BORDIT TË DREJTORËVE TË
SHOQËRISË SË SIGURIMIT “SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, neneve 17, 20, 21 dhe 25, të ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, rregullores nr.137, datë 21.12.2015 “Mbi procedurën, afatet dhe dokumentacionin e nevojshëm/shtesë për miratimin e emërimit dhe riemërimit të anëtarit të Këshillit të Administrimit/Mbikëqyrës, Administratorit/Anëtarit të Bordit të Drejtorëve të shoqërisë së sigurimit”, e ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e riemërimit të z. Artan Pjetërnikaj si anëtar i bordit të drejtorëve të shoqërisë së sigurimit “Sigma Vienna Insurance Group” sh.a., për një afat 3 vjeçar, deri në datë 20.06.2029.**
- 2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Saimir TOLA

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Adela XHEMALI